

**Agim ZOGAJ**

**Historik i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, në javoren  
“Zëri”, dhjetor 1997-mars 1999**

Javorja politike shqiptare “Zëri”, padyshim është ndër të parat që me shkrimet e veta, menjëherë pas daljes së komunikatave të para të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, arriti që të sensibilizojë opinionin shqiptar, por edhe atë ndërkombëtar me aktivitetet luftarake dhe politike të UÇK-së që nga paraqitja e saj. Shkrimet, analizat, komentet, intervistat me aktorë, udhëheqës të UÇK-së, me politikanë, studiues, analistë vendorë si dhe ata ndërkombëtarë, i dhanë fuqizim afirmimit të luftës së popullit të Kosovës me në krye UÇK-në për çlirimin nga pushtimi serb/jugosllav. Javorja politike shqiptare, “Zëri”, me temat e drejtpërdrejta, me intervista të shumta politike, që për temë e kishin daljen dhe luftën e UÇK-së si dhe me reportazhet nga fushëbetejat kishte sensibilizuar jo vetëm opinionin mbarëshqiptar, por edhe atë ndërkombëtar të kohës, sepse diplomatë të shumtë të asaj kohe kishin dhënë intervista, pikëpamjet e tyre dhe të qeverive të shumta euro-perëndimore për luftën çlirimtare të popullit të Kosovës. Kështu, përmes shkrimeve, raporteve nga fushëbeteja, komenteve, editorialeve, intervistave me personalitete të shquara ndërkombëtare, “Zëri” arriti që, para publikut shqiptar gjithandej të shpalos, të identifikojë dhe jo vetëm të regjistrojë opinionet, vlerësimet dhe qëndrimet e diplomacisë ndërkombëtare në lidhje me luftën e UÇK-së. Kështu, në numrin e datës 6 dhjetor të vitit 1997 “Zëri” në shkrimin me titull: “UÇK: Një kronologji e shkruar me komunikata”, nënvizon se: “ ...shikuar në

retrospektivë, qysh nga paraqitja e komunikatës së parë në opinionin e UÇK-së, rrethe të caktuara politike kosovare patën treguar një dozë të caktuar rezervë, lidhur me ekzistencën dhe veprimtarinë e kësaj organizate<sup>1</sup>. Sipas artikullshkruesit të “Zërit”, një qëndrim i tillë është “mbajtur për një kohë relativisht të gjatë”.<sup>2</sup>Pra, gjithnjë sipas “Zërit”, mund të kuptohet se, në opinionin publik, politik shqiptar në Kosovë, ende vazhdonte të kishte një paqartësi në lidhje me ekzistimin, veprimin e UÇK-së, prandaj edhe përmbajtja e kumtesave të publikuara nga shtabet politike të UÇK-së ishin të interpretuara nga shumë këndvështrime. Ndër opinionet e ndryshme, të cilat, gjithsesi më tepër mund të konsideroheshin se ishin luftë speciale e shërbimeve sekrete të Serbisë, ishte përshtypja, spekulimi se ato po i “shkruan” shërbimi sekret serb për të krijuar huti, paqartësi në opinionin shqiptar. Madje, kishte ide, pikëpamje, sikur Serbia kishte dorë në ato komunikata me emblemën e UÇK-së, me qëllim për të krijuar pretekst për ta rritur edhe më fuqishëm dhunën ndaj popullatës së pambrojtur shqiptare të Kosovës. Më pas, autori i shkrimit, duke bërë një retrospektivë kronologjike të daljes së parë publike të komunikatave të UÇK-së, shkruan se, më 17 shkurt të vitit 1996, në gazetën “Bujku”, është botuar komunikata e parë publike e UÇK-së.<sup>3</sup> Kjo e dhënë, ky fakt, gjithsesi është me interes të madh për studiuesit e historisë së lindjes dhe veprimtarisë së UÇK-së.

Artikullshkruesi, pasi thekson interesimin e opinionit për të ditur më shumë, madje siç shprehet, për të vërtetën për UÇK-në, më tej konstaton se “me gjasë e vërteta e plotë për UÇK-në do të tregohet më

---

<sup>1</sup> “Zëri”, 06/12/1997, Prishtinë.

<sup>2</sup> *Po aty*.

<sup>3</sup> “Bujku”, 17/02/1996.

vonë".<sup>4</sup> Kuptohet, ishte kohë kur Ilegalja Atdhetare Shqiptare, pra, dhe Ushtria Çlirimtare e Kosovës, që në fakt ishte krahu i armatosur, ushtria e Ilegalës Atdhetare Shqiptare po vepronte në ilegalitet të thellë dhe, pikërisht nga e forta e veprimit ilegal, politik dhe të aksioneve ushtarake po krijonte opinion publik, simpati, përkrahje dhe po e fuqizonte moralin e popullit për luftë të armatosur.

"Zëri" në numrin e datës 13 dhjetor të vitit 1997, trajton në mënyre analitike dhe për herë të parë me qasje dukshëm më transparente fenomenin e UÇK-së. I themi fenomeni i UÇK-së, sepse për kohën, UÇK-ja ende po vepronte nga ilegaliteti i thellë dhe natyrisht se, për shumë kë, nuk mund të kuptohej se ishte themeluar dhe po vepronte ushtria e djemve të Kosovës, pra, Ushtria Çlirimtare e Kosovës. Presioni sistematik i pushtetit serb, sundimi gati njëshekullor i Serbisë, përkatësisht i Jugosllavisë mbretërore dhe i Jugosllavisë AVNOJI-ane kishin lënë pasoja, gjurmë të thella në psikologjinë e popullit shqiptar, i cili, edhe pse kishte zhvilluar kryengritje të shumta kundër pushtimit serb/jugosllav asnjëherë nuk kishte pasur aleat përveç përkrahjes, më tepër politike, morale, vëllazërore të shtetit shqiptar. Kësaj radhe në shkrimin me titull: "Kompromiset dhe guerilja" artikullshkruesi, pasi vlerëson se "rezistenca e Drenicës sfidon fuqinë kontrolluese të ushtrisë serbe" më tej konstaton se "UÇK-ja tashmë ka demonstruar prezencën dhe aftësinë e organizimit të aksioneve në të gjitha viset e Kosovës". Prandaj, artikullshkruesi konstaton se: "Sa i përket UÇK-së, që ditëve të fundit fitoi një publicitet të gjerë, gjëja më e rëndësishme në paraqitjen e kësaj ushtrie nuk ishte vetë fakti i daljes në skenë publike, sa ishte me rëndësi duartrokitja dhe brohoritja e popullit. Autori, i cili

---

<sup>4</sup>Po aty.

mendon se kualifikimi më i saktë për UÇK-në do të ishte ai i gueriles specifike shqiptare, si një lëvizje çlirimtare e drejtuar kundër pushtuesit, mendon se “ problemi i Kosovës qëndron te terrorizmi shtetëror serb, dhe jo te UÇK-ja”.

“Zëri”, gjatë periudhës së viteve 1997,1998 dhe 1999, në drejtim të sensibilizimit të opinionit ndërkombëtar rreth luftës çlirimtare të UÇK-së dhe të popullit shqiptar të Kosovës, kishte bërë depërtimin e rëndësishëm përmes intervistave me personalitete të larta të diplomacisë, publicistë, analistë dhe ekspertë ndërkombëtarë.

Kështu, Pitër Kingç, bashkëkryetar i Komitetit për çështje shqiptare në Kongresin Amerikan, në intervistën për “Zëri”, të datës 13 dhjetor 1997, me titull: “UÇK-ja është rezultat i injorimit të Rugovës nga Serbia dhe Amerika”, mes tjerash deklaroi, se: “sa di unë, qeveria jonë ende nuk e ka të qartë se kush është prapa UÇK-së”, ndërsa sipas diplomatit amerikan, personalitetet e UÇK-së kanë arritur në përfundim se “nuk ka alternativa tjera për zgjedhjen e problemit përveç përdorimit të dhunës kundër regjimit serb”.<sup>5</sup> Ishin ato, opinionet e para, të dhëna një medie shqiptare, të një diplomati të lartë amerikan, i cili siç shihet nga vlerësimet etij, pranonte se, për atë kohë, pra dhjetor 1997 edhe Stejt Departamenti Amerikan nuk kishte informacione të mjaftueshme, bazike për atë se, kush qëndronte prapa UÇK-së. Por, diplomati amerikan, Piter Kingç megjithatë konstaton se, fakti që politika pacifiste e Rugovës /LDK-së/ nuk po jepte rezultatet në çlirimin e Kosovës nga sundimi serb, ishte ndër faktorët që determinoi organizimin ushtarak të popullit të Kosovës, gjithnjë nën drejtimin e UÇK-së e themeluar nga Ilegalja Atdhetare Shqiptare /Lëvizja Popullore e Kosovës/.

---

<sup>5</sup> “Zëri” 1997/1998/1999.

"Zëri", në numrin e datës 27 dhjetor të vitit 1997, boton intervistën me Ibrahim Rugovën i cili, për herë të parë, drejtpërdrejt në një pyetje rreth UÇK-së deklaroi se: "Shumë është duke u spekuluar rreth atij grupi, siç thuhet, se unë nuk kam informacione se ekziston një formacion e organizatë e tillë në Kosovë".<sup>6</sup> Në numrin e parë të janarit 1998, në shkrimin me titull: "Qetësia mashtruese para stuhisë", artikullshkruesi i "Zërit", sikur paralajmëron qasje edhe më analitike dhe më të drejtpërdrejtë rreth zhvillimeve në Kosovë. Pasi konstaton se në mozaikun e politikës nacionale të Kosovës është shfaqur UÇK-ja, autori shkruan se: "Me shfaqjen e UÇK-së, duket që në Kosovë lindi një front tjetër i refuzimit, jo vetëm pasiv, por një i armatosur. Autori konstaton se ekzistimi i UÇK-së, tashmë është një realitet, ndërsa diskutimet pro dhe kundër ekzistimit të UÇK-së janë ndezur edhe në Shqipëri, duke cituar deklaratat e Neritan Cekës, Pandeli Majkos, Sali Berishës etj. Ndërsa, lidhur me heshtjen e LDK-së lidhur me UÇK-në, autori shkruan se LDK-ja nuk guxon edhe gjatë ta fus kokën në zall dhe ta vërshojë popullin me deklarata tashmë qesharake, se nuk kemi informata për UÇK-në, kur pjesëtarët e armatosur të UÇK-së u japin intervista edhe para gazetave të huaja. Në të njëjtin numër, në shkrimin me titull: "Uashingtoni pret prononcimin e udhëheqjes së Kosovës rreth UÇK-së", të shkruar nga korrespondenti i "Zërit" në Nju Jork, artikullshkruesi bën të ditur se "Së shpejti CIA do të ftohet për t'u informuar më hollësisht disa kongresistë rreth UÇK-së dhe udhëheqjes së Kosovës, e cila deri më tani ju ka shmangur përgjegjësisë, duke u shprehur "se nuk ka informacione për një organizatë të tillë, do të bëhet trysni që të deklarohet dhe ta denoncoj UÇK-në". Pra, gjithnjë sipas korrespondentit të javores politike shqiptare "Zëri" nga Uashingtoni,

---

<sup>6</sup>Po aty, 27/12/1997.

Qeveria amerikane i përcillte me shumë kujdes zhvillimet në Kosovë, pra, veçmas paraqitjen e UÇK-së, rolin e saj, qëllimet, objektivat, mënyrën e organizimit, fuqinë e saj ushtarake, politike si dhe ndikimin në popullatën shqiptare.

Në numrin e 24 janarit të vitit 1998, “Zëri” sjell intervistën me Xhafer Shatrin, atëherë ministër për Informim në Qeverinë në ekzil të Republikës së Kosovës, i cili në mes tjerash pasi apostrofon se ne duhet ta shohim realitetin në sy, deklaron se: “Nuk mund të themi tash se UÇK-ja nuk ekziston se është dorë e zgjatur e Serbisë dhe se njerëzit me dy fije mend në kokë nuk guxojnë të sillen në mënyrë kaq të papërgjegjshme. UÇK-ja ekziston”. Shatri, më tej duke dhënë shpjegime për shkaqet që sollën deri te paraqitja e UÇK-së, nënvizon terrorizmin sistematik serb, indiferencën e Fuqive të Mëdha, si dhe, paaftësinë dhe papërgjegjësinë e udhëheqjes së Kosovës. Artikullshkruesi në “Zërin” e 31 janar 1997, pra pas sulmit të parë serb mbi familjen e Jasharajve, në shkrimin me titull: “Shaban Jashari, apo “Dy duar për një krye”, shkruan se vetëm fjalitë e Shaban Jasharit kanë frymë e shpirt: “Unë kam vetëm një shtëpi dhe prej saj nuk kam ku të shkojë”<sup>7</sup>. Në të njëjtin numër, “Zëri” boton një reportazh të gjatë për historinë e familjes Jashari, të realizuar nga autori i kësaj kumtese, në odën e kryeplakut Shaban Murat Jashari.<sup>8</sup>

“Zëri”, në një vështrim të korrespondentit të vetë nga Nju Jorku, të datës 28 shkurt 1998, sikur paralajmëronte një intonacion krejtësisht tjetër të zyrtarëve amerikanë rreth paraqitjes dhe aktiviteteve luftarake të UÇK-së. Ishte ajo periudha kur diplomacia amerikane, pa prituri dhe në befasi i ndryshon pozicionimet e veta rreth rolit të UÇK-së.

---

<sup>7</sup> “Zëri”, 31/01/1997.

<sup>8</sup>*Po aty.*

Artikullshkruesi, në korrespondencën nga Nju Jorku, shkruante se, sipas disa diplomatëve amerikanë dhe politikanëve amerikanë, UÇK-ja së shpejti mund të shpallet organizatë terroriste dhe të gjithë ata që kanë pasur kontakte apo kanë kontribuar për fondin e saj, mund të vihen në pozita të palakmueshme sa i përket karrierës së tyre në diplomaci. Këto vlerësime në diplomacinë amerikane arritën pas vizitës së Robert Gelbard në Kosovë, kur ai, në takim me Ibrahim Rugovën dhe madje edhe në konferencën e mbajtur për shtyp, bëri trysni mbi palën shqiptare dhe e denoncoi UÇK-në. Paraqitja e diplomatit Robert Gelbard, ishte e papritur dhe kishte krijuar huti të madhe në opinionin publik të Kosovës dhe përgjithësisht në opinionin shqiptar. Sigurisht, edhe shumë nivele, qarqe të diplomacisë ndërkombëtare të kohës, pra jo vetëm udhëheqja serbe e kishin komentuar atë deklaratë dhe atë ndryshim të kursit diplomatik të Qeverisë amerikane rreth rolit të UÇK-së.

Paraqitja e parë e një politikani shqiptar i cili në mënyrë transparente flet për UÇK-në, është realizuar në "Zërin" e 14 marsit të vitit 1998, në vështrimin editorial të Adem Demaçit, që mbante titullin: "Ballë për ballë me UÇK-në". Demaçi me guximin intelektual, kombëtar dhe politik, vlerësonte se "Dalja në skenën tonë politike e UÇK-së është shfaqja më e re dhe më e befasishme gjatë pesëdhjetë vjetëve të fundit".<sup>9</sup> Prandaj, Demaçi konstatoje se: "Kjo forcë e organizuar serioze ilegale po sfidon në mënyrë mëtë mirë jo vetëm regjimin serb jo vetëm politikën tonë të rezistencës paqësore, por edhe politikën ballkanik, evropiane dhe botërore".

Demaçi vlerëson se me shfaqjen e UÇK-së regjimi serb i është prishur krejtësisht projekti i zgjedhjes së çështjes së Kosovës, pra, sipas

---

<sup>9</sup> "Zëri", 14/03/1998.

Demaçit, i ishte prishur plani për serbizimin e Kosovës dhe se “Kur UÇK-ja doli me kumtesën se ajo nuk do të pranoj kurrfarë marrëveshje për Kosovën pa pjesëmarrjen e saj në negociata, atëherë gjërat ndryshuan diametralisht”.

“Zëri”, në një analizë të shkrimeve të shtypit perëndimor rreth UÇK-së me botimin e datës 11 prill 1998, shkruan se: “Fakti se UÇK-së i mungon krahu politik dhe përvoja e strategjisë luftarake, e bën edhe më lehtë për shënjestrën e armatimit të rënd serb, që rrezikon jo vetëm UÇK-në por edhe popullatën shqiptare në tërësi”. Ishte ai një shqetësim real, i arsyeshëm dhe i drejtpërdrejtë për kohën, ndërkohë që, zhvillimet e mëtejshme brenda UÇK-së dëshmojnë se, ishte forcuar edhe krahu politik, të cilin e drejtonte, drejtori i Drejtorisë Politike të UÇK-së, z. Hashim Thaçi. “Zëri”, me këtë rast, citon një ekspert ushtarak amerikan, i cili kishte deklaruar se: “Fakti që popullata shqiptare tash është e ndarë midis UÇK-së dhe politikës paqësore, do t’i kushtonte shtrenjtë Kosovës”. Ishte muaji prill, 1998 kur në të njëjtin numër “Zëri”, shkruante se: “Për UÇK-në në qarqet politike shqiptare edhe më tej, ka një heshtje ose së paku mëdyshje se a duhet bërë apo jo analiza publike e veprimeve dhe e qëllimeve të saj”, për të konstatuar se: “Tashmë duket se UÇK-ja po zhvillohet në një organizatë të fuqishme guerile, madje se është duke u vënë në ballë të rebelimit dhe të kryengritjes”. Artikullshkruesi, me të drejtë konstaton se “Politika e UÇK-së bie ndesh me përcaktimin e udhëheqjes politike, se zgjidhja e statusit të Kosovës duhet të arrihet me mjete politike dhe negociata, kurse UÇK-ja preferon luftën e armatosur”.

“Zëri”, në numrin e 9 majit 1998, vazhdon të merret me temën e titulluar: “Sqarimet me UÇK-në”.<sup>10</sup> Artikullshkruesi, pasi konstaton se

---

<sup>10</sup> “Zëri”, 9/05/1998.

“nuk ka më aspak dyshim në ngritjen rapide të kësaj organizate”, vlerëson se “Vetë forcimi i UÇK-së me rekrutimin e disa mijëra luftëtarëve, shënon kthesë të madhe dhe se UÇK-ja paraqitet si forcë reale vepruese që sfidon ndryshimin rrënjësor jo vetëm të raportit të forcave në skenën politike kosovare, por edhe përgjithësisht të raporteve në skenën mbarëkombëtare”. Autori më tej vlerëson se: “Në udhëheqjen e UÇK-së sikur ekziston bindja se konfliktet e tashme nuk janë vetëm kryengritje ndaj pushtimit serb, por kjo është njëkohësisht kryengritja edhe kundër pushteteve shqiptare, qoftë në Kosovë, në Shqipëri apo në Maqedoni, derisa këto pushtetet udhëheqin një strategji të gabueshme dhe presin kot që zgjidhja e çështjes kombëtare të realizohet vetëm me mjetet politike”. Zhvillimet politike të determinuar nga veprimet çlirimtare të UÇK-së, bën që, megjithatë, edhe në skenën e diplomacisë ndërkombëtare, të ketë evoluime pozitive karshi synimeve kombëtare të UÇK-së. “Zëri”, duke përcjellë me pedanteri një varg tubimesh që në maj të vitit 1998 ishin mbajtur në Nju Jork, gjithnjë në mbështetje të UÇK-së me shkrimin me titull: “UÇK-ja në Amerikë”, të botuar më 16 maj të vitit 1998, citonte një gjeneral shqiptar, i cili në një tubim të shqiptarëve në Nju Jork, Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës e kishte quajtur një fëmijë të shëndosh, i cili duhet të ndihmohet që të rritet”. Kurse, gjithnjë sipas artikullit të sipërcituar, Xhozef Dioguardi kishte propozuar që UÇK-ja të futet nën organet legjitime të Republikës së Kosovës, në mënyrë që njerëzit si Gelbard të mos kenë mundësi manipulimi me terma. Në të njëjtin numër të “Zërit”, korrespondenti i saj i përhershëm nga Nju Jorku analizontese “Kumtesa e fundit e komandës së UÇK-së të lë përshtypjen e një vetëbesimi në rritjen e kësaj organizate, që tashmë e konsideron vetën si faktorë më se relevant, nëse jo edhe vendimtar, për

zgjidhjen e çështjes së Kosovës dhe se supozohet se Beogradi nuk ka llogaritur me një forcim kaq marramendës të UÇK-së”.

Në reportazhin me titull: “Me ata që luftojnë e besojnë në lirinë e Kosovës”, botuar në “Zërin” e 30 majit 1998, artikullshkruesi citon një pjesëtar të UÇK-së, i cili duke vënë mesazhin e luftëtarit të lirisë shprehet se: “Me dëshirën më të madhe jemi të gatshëm të japim edhe jetën për Kosovën, se më e shtrenjtë është liria sesa jeta, se vdekja për lirinë e Kosovës do të ishte fati im më i madh jetësor dhe se vetëm pavarësia e Kosovës është zgjidhje e drejtë”.

“Zëri” i datës 6 qershor 1998, boton intervistën me Bujar Bukoshin, kryeministër i Qeverisë së Republikës së Kosovës në ekzil, i cili pasi konstaton se Qeveria nuk e ka formuar UÇK-në, më tej shprehte se: “...natyrisht se UÇK-ja është një realitet siç është realiteti dhe fillimi i realizimit të kryengritjes popullore të armatosur kundër agresionit serb”. Pra, kryeministri në ekzil i Qeverisë së Republikës së Kosovës, z. Bukoshi e deklaronte hapur përkrahjen e tij për UÇK-në, realitet siç e thoshte, i realizimit të kryengritjes popullore të armatosur kundër pushtuesit serb. “Zëri”, në të njëjtin numër në shkrimin e korrespondentit të vetë nga Brukseli, shkruan se lidhur me ndryshimin e pikëpamjeve dhe cilësimeve të bashkësisë ndërkombëtare lidhur me UÇK-në, përshkrimi më i mirë haset tek diplomati i NATO-s, Jamie Shea, cili thotë se “sa herë që forcat serbe sulmojnë një fshatë, disa të rinj më tepër inkuadrohen në UÇK”. Artikullshkruesi, gjithashtu konstaton se, më as Primakovi, ministër i Jashtëm rus, nuk e quan UÇK-në organizatë “terroriste”. “Zëri” në numrin e 13 qershorit të vitit 1998, kur nga dita në ditë rriteshin fushatat militare serbe kundër luftës çlirimtare të UÇK-së, vlerësonte se “Strategjia e Beogradit është që të pengojë krijimin e një guerile shqiptare më efektive, duke e detyruar

UÇK-në që të krijojë formacione më të mëdha. Mund të supozohet se strategjia e komandës serbe për fazën e dytë do të ishte me qëllim që të asgjësojë formacionin e UÇK-së, ose të dëbohen përtej kufirit në Shqipëri. Po në të njëjtin numër, "Zëri" boton intervistën me Hydajet Hysenin, i cili pasi konstaton se UÇK-ja është produkt i realitetit tonë, ai vlerëson se "faktorët të tillë, si UÇK-ja janë faktorë tejet seriozë dhe me ndikim të jashtëzakonshëm".

Në ditën e muajit qershor, 1998 kur Millosheviqi e kushtëzonte tërheqjen e njërive intervenuese policore ushtarake nga Kosova me tërheqjen dhe ndërprerjen e aktiviteteve luftarake të UÇK-së, "Zëri" në numrin e 20 qershorit të vitit 1998, shkruante se UÇK-ja sigurisht se nuk ka ndërmend që t'u bindet premtimeve të Beogradit, sikur që nuk do t'i bindet lehtë as porosive të udhëheqjes politike shqiptare në Prishtinë dhe gjetiu, për t'u ndërprerë aksionet".<sup>11</sup>

"Zëri" në numrin, 20/06/1998 boton intervistën me zëdhënësin e UÇK-së, Jakup Krasniqi, i cili deklaroi se: "UÇK-ja është jashtë çdo ombrelle partiake, kurse për ideologji ka shqiptarizmin". Jakup Krasniqi ishte në funksion të qartësimit të strategjisë dhe misionit kombëtar, historik të UÇK-së, pra, siç e thoshte ai vet, UÇK-ja për ideologji e ka shqiptarizmin! Sigurisht, ish-zëdhënësi i UÇK-së, Krasniqi, me një deklaratë të tillë u jepte përgjigje edhe atyre zërave, të cilët spekulonin se, UÇK-ja përmban ideologji majtiste, revolucionare e çka tjetër. Krasniqi, siç del nga përmbajtja e atyre deklaratave të botuara në faqet e javores politike shqiptare "Zëri" ishte shumë i qartë dhe i prerë duke deklaruar se, programi i UÇK-së ishte Program Kombëtar dhe jo ideologjik e as partiak apo krahinor!

---

<sup>11</sup> "Zëri", 20/06/1998.

“Zëri” në numrin e 11 korrikut 1998 botoi intervistën me Janush Bugajskin, analist i njohur amerikan, i cili pasi vlerëson se “pjesëmarrja e UÇK-së është më se e domosdoshme në çdo bisedim”, thekson se “ajo tash është shndërruar në një forcë serioze lufte dhe se në rastin eventual politika e Shqipërisë do të kanalizohet drejt mbështetjes të UÇK-së drejt një pavarësie”. Pra, Bugajski, një analist shumë prestigjioz amerikan, njohës i shkëlqyeshëm i rrethanave në Evropën Juglindore, përkrahës i luftës së drejtë çlirimtare të popullit të Kosovës nën udhëheqjen e UÇK-së, jepte vlerësim realist dhe ishte i bindur se, pjesëmarrja e UÇK-së në çdo lloj bisedimi me Serbinë dhe me faktorë ndërkombëtarë, ishte e domosdoshme. Një vlerësim i tillë, i cili vinte nga analistë ndërkombëtarë ishte i rëndësishëm, sepse e legjitimonte luftën e drejtë të UÇK-së dhe në fakt, impononte qëndrimin se, UÇK-ja duhet të jetë faktor në bisedime politike dhe partner i barabartë në çfarëdo niveli të bisedimeve me ndërmjetësim ndërkombëtar midis Kosovës dhe Serbisë.

Një vështrimin tjetër i “Zërit”, i datës 18 korrik1998, artikullshkruesi vlerëson se “Supozohet se ngritja e shpejtë e UÇK-së i ka tejkaluar të gjitha parashikimet manipuluese të Beogradit dhe se ai u tmerrohet pasojave të parashikuara të kryengritjes masive”. Në këtë drejtim autori mbron pikëpamjen se, potencialet e UÇK-së janë vërtet të mëdha. Në të njëjtin numër botohet intervista me Jakup Krasniqin, zëdhënës i UÇK-së, i cili deklaroi se UÇK-ja është perspektiva dhe ardhmëria e Kosovës, dhe se rezultatet konkrete të arritura në terren kanë bërë që UÇK-në ta njohë më parë faktori ndërkombëtar se sa ai i brendshëm. Ish-zëdhënësi i UÇK-së, Krasniqi, sikur me atë qëndrim, pikëpamje, dëshironte t’i bënte me dije opinionit të gjerë shqiptarë se, përbrenda faktorit politik shqiptar, në Kosovë dhe më gjerë, ende kishte

forca të caktuara politike të cilat hezitonin ta pranonin, ta njihnin fuqinë, rolin, misionin historik, kombëtar të UÇK-së, e cila ishte bërë e njohur, si forcë ushtarake dhe politike edhe në disa qarqe diplomatike ndërkombëtare. Lidhur me krijimin e institucioneve shtetërore dhe kombëtare, Krasniqi prononcohet se krijimin e tyre do ta diktoj UÇK-ja, duke çliruar territore të reja. Në numrin e përmendur të "Zërit", pra të datës 19 korrik 1998, botohet edhe intervista me Ismail Kadarenë, i cili shprehet se: "Që sot, ata djem dhe ato vasha të UÇK-së bëjnë pjesë në historinë morale të kombit, se UÇK-ja ringjalli vlerën e idealeve. "Zëri" në numrin e 1 gushtit 1998, boton intervistën ekskluzive me Sabit Gecin, njëri ndër luftëtarët e parë të UÇK-së, njërin ndër komandantët më në zë dhe më të shquar të zonave operative të UÇK-së, i cili deklaronte se luftën e kemi fituar në momenti kur i rrokëm armët. Geci, në pyetjen e gazetares se a mendon se UÇK-ja duhet ta zgjidh problemin e Kosovës, është përgjigjur se: "Ajo duhet ta çliroj Kosovën, UÇK-ja ka mjaft forcë, ka njerëz, armatim dhe ajo do ta sjellë lirinë e Kosovës".

Në numrin e 28 gushtit të vitit 1998, "Zëri", duke komentuar dështimin e përpjekjeve për arritjen e marrëveshjeve brenda shqiptare, rreth formimit të grupit negociator, kur pritej të kishte përfaqësues edhe të UÇK-së, mes tjerash shkruan se: "...UÇK-ja mbeti e papërfshirë në grupin negociator, fat ky i keq si për UÇK-në, aq më tepër për grupin negociator, e më së keqi për Kosovën". Në të njëjtin numër botohet intervista me Adem Demaçin, aso kohe në detyrën e përfaqësuesit politik të UÇK-së, i cili deklaroi se: "UÇK-ja do të kundërshtojë çdo zgjidhje që është nën përcaktimin e popullit në referendumin e vitit 1991", për të shtuar se: "Nuk është zor t'i gjesh njëqind vetë të thonë "kuku na mori në qafë UÇK-ja", por shumica e popullit nuk e tradhtoi

UÇK-në, sepse ajo është ushtria e vetë”. Ndërsa, në temën rreth përçarjeve të mundshme në radhët e UÇK-së, Demaçi shprehej: “Unë besoj që nuk do të arrijë asnjë dorë të fusë farën e përçarjes në UÇK-së, ky do të ishte një rrezik i madh për të gjithë ne e jo vetëm për UÇK-në”. “Zëri” në të njëjtin numër boton intervistën ekskluzive me Naim Malokun (të realizuar nga autori i kësaj kumtese - A. Z, i cili ishte korrespondent lufte nga Kosova për programin shqip të Radio “DeutscheWelle”), oficer i lartë i UÇK-së i cili deklaroi se: “Në UÇK nuk ka fraksione politike, se kur është fjala në çështjet esenciale ushtarake, atëherë qëndrimi i të gjithë ushtarëve dhe eprorëve të UÇK-së është i njëjtë dhe i ditur. Ai qëndrim është mbrojtja e këtij populli dhe çlirimi i Kosovës”. Në të njëjtin numër, botohet intervista me Sali Berishën, i cili pasi deklaroi se e ka përkrahur UÇK-në, shprehet se: “I kam bërë thirrje UÇK-së në mënyrë sistematike që të bashkëpunojë me faktorin politik”, për të shtuar se UÇK-ja ka miq dhe ajo duhet t’i dëgjoj këshillat e miqve. Në atë muaj të vjeshtës 1998, ishin ndezur diskutimet brenda spektrit politik shqiptar, për institucionalizimin e UÇK-së, për vënien e saj nën kontroll institucional dhe lidhur me këta zëra, Bajram Kosumi, në shkrimin me titull institucionet dhe pseudo institucionet, shkruante se: “Do të ishte e panatyrshme që UÇK-ja të jetë e nënshtruar ndaj pseudo institucioneve të Kosovës dhe ndaj partive politike”.

Nga leximi i shkrimeve të “Zërit” të datës 12 shtator 1998, lidhur me UÇK-në, vlen të përmendet deklarata e Wolfgang Syshel, atëherë diplomatë i lartë austriak, më pastaj edhe ministër i Punëve të Jashtme të Austrisë, i cili shprehimisht, për lexuesit shqiptarë kishte deklaruar se: “E dini se nuk e mbështes UÇK-në, dhe e dini se po flas publikisht e jo heshtazi kundër mbështetjes së UÇK-së”. Ishte, për kohën politike

dhe për relacionet e atëhershme ndërkombëtare një pikëpamje, thuajse e vetmuar e diplomatit austriak, i cili, pas fillimit të bombardimeve të NATO-së mbi caqet e ushtrisë serbe, kishte lëvizur nga ai qëndrim. Diplomati austriak preferonte, siç shprehej ai, që të mbështeste "Forcat e moderuara". Ndërsa, në të njëjtin numër, Ema Bonin, komisionere e Unionit Evropian për çështje humanitare shprehej se: "Unë personalisht e shoh shumë të çuditshme që të vihet në të njëjtin rang përgjegjësit e armatës serbe dhe përgjegjësit e UÇK-së". Pra, ishte qershori i vitit 1998 dhe analizuar intervistën e ministrit të Jashtëm të Austrisë si dhe deklaratën, po në të njëjtën numër të javores "Zëri", pra të Ema Bonino, komisionere e Unionit Evropian për çështje humanitare mund të kuptohej hapur se çfarë pikëpamje kundërtëne, pra edhe në nivele të faktorëve, institucioneve ndërkombëtare, kishte për luftën në Kosovës, për rolin UÇK-së në luftën çlirimtare etj.

Në numrin e 3 tetorit të vitit 1998, "Zëri" paraqet opinionet e Bardhyl Mahmutit, atëherë përfaqësues politik dhe zëdhënës i jashtëm i UÇK-së, i cili pasi deklaroi se UÇK-ja është institucioni më legjitim në Kosovë, kërkesave të qarqeve të caktuara politike për institucionalizimin e UÇK-së iu përgjigjet me fjalët se: "Çdo ushtar i UÇK-së duhet ta dijë se prapa kërkesave për institucionalizimin fshihet synimi për ta instrumentalizuar UÇK-në se çdo përpjekje në këtë drejtim do të dështojë". Kjo sepse, siç e deklaronte zëdhënësi i jashtëm i UÇK-së "Lufta për liri dhe pavarësi, e mishëruar në UÇK-në, është institucioni më i shenjtë deri në realizimi e aspiratave tona kombëtare". Pra, përgjigja e Bardhyl Mahmutit, një ndër veprimtarët e devotshëm të Ilegalës Atdhetare Shqiptare për çlirimin e Kosovës dhe bashkimin me Shqipëri, në rastin e mësipërm zëdhënës i UÇK-së në Evropë, ishte

shumë e qartë për të gjithë ata të cilët ende nuk e pranonin fuqinë, faktorizimin e UÇK-së.

Për artikullshkruesin e vështirimit me titull: “Kornizat e parapërcaktuara”, botuar në “Zëri” e 11 tetorit 1998, nuk kishte dilema për faktin se “I vetmi faktor realisht veprues në hapësirën shqiptare në këto kushte ishte UÇK-ja dhe se në esencë, po të mos ishte UÇK-ja, as që do të vinim në këtë situatë të fillimit të zgjidhjes së krizës me intervenimet e NATO-s dhe krijimin e kushteve kalimtare”. Në të njëjtin numër, botohet intervistat e gjatë me Jakup Krasniqin, i cili në pyetjen për tendencat për anashkalimin të UÇK-së nga subjektet kosovare, përgjigjet: “Mendoj se me rezistencën që po bën UÇK-ja, me qëndrimet e saj të qarta për pavarësinë e Kosovës, do ta kryejë punën në atë mënyrë, që ata që dëshirojnë ta anashkalojnë UÇK-në do ta anashkalojnë vetveten”.

Në “Zërin” e datës 14 nëntor 1998, lexojmë intervistën e realizuar me Shaban Shalën, oficer i lartë i UÇK-së, i cili konstatonte se divergjencat politike shqiptare kanë pasoja të mëdha për ardhmërinë. Më tej, Shala duke shpjeguar faktin pse një pjesë e madhe e eprorëve ushtarakë shqiptarë që kishin shërbyer në ish-AJ, nuk janë përfshirë në UÇK, përkundër ftesës së Shtabit të Përgjithshëm, vlerëson se: “Kolegët e mi, oficerë ushtarakë me profesion, kanë rënë pre dhe janë pengje të një politike të gabuar që udhëhiqet nga klasa politike e Kosovës”. Ai shtonte se: “Një pjesë e oficerëve ka lejuar që të manipulohet me ta për interesa personale, grupe të udhëheqësve tanë”.

“Zëri” në numrin e 21 nëntorit 1998, në temë për mundësitë e bashkimit politik të faktorit shqiptar, mes tjerash boton deklaratën me Jakup Krasniqin, zëdhënës i SHP të UÇK-së, i cili shprehje se: “Vetëm

bashkimi është shpëtim i ynë, se UÇK-ja nuk kërkon të jetë e privilegjuar në këtë kthesë të madhe historike, por nuk do të lejojë që të anashkalohet". Ndërsa, në numrin vijues të javores "Zëri" të datës 24 tetor 1998, Adem Demaçi, përfaqësues i përgjithshëm politik i UÇK-së, shprehimisht vlerësonte, e kërkonte se: "UÇK-ja duhet të ketë rolin kryesor dhe vendimtar në arritjen e marrëveshjes për zgjidhjen e problemit të Kosovës".

Në numrin e 26 dhjetorit të vitit 1998, artikullshkruesi në "Zëri" pasi konstatonse çdo gjë është bërë e padurueshme, shkruan se: "UÇK-ja bëhet faktor numër një, bëhet faktor edukativ, kategori filozofike dhe pedagogjike, UÇK-ja potencon Kosovën, të drejtën e saj dhe e vazhdon traditën heroike". Në të njëjtin numër në vështimin me titull: "Ndërrimi i epokës" autori për Adem Jasharin shkruan si për njeriun që e ndërroi epokën, për Fehmi Lladrovcin, si për heroin i cili i jepet tërësisht lirisë së atdheut, për Lum Haxhiun si për "Çe Gevaren" e Junikut, Adem Jashari si "Shin Fejnin" shqiptar, për Hashim Thaçin si i ashpër por kooperativ /bashkëpunues/ i vendosur, trim dhe tolerant, e kështu me radhë. Po më këso deklarata të larta mirënjohje për UÇK-në aso kohe deklarohen edhe personalitete, diplomatë dhe analistë ndërkombëtarë, siç ishte fjala me analistë të njohur anglezë, Timoti Garton, i cili po ashtu në numrin e javores "Zëri" të datës 23 janar 1999, shkruante se: "Është e vërtetë se pjesëtarët e UÇK-së janë heronj për shumicën e shqiptarëve të Kosovës. Të arriturat e tyre tashmë janë legjendë, gati për të hyrë në librat e historisë, padyshim, në të njëjtën masë të mitizuar për luftëtarët kryengritës kaçakë kundër serbëve, para tetëdhjetë vjetëshdhe se forca politike e UÇK-së është në rritje e sipër". Ishte ai një vlerësim realist i një ndër mbështetësve të parë dhe të fuqishëm ndërkombëtar për UÇK-në.

Do të ishte me shumë interes që sot, pas luftës çlirimtare të Kosovës dhe çlirimit të vendit tonë nga sundimi serb/sllav, pikërisht kur po atakohen dhe denigrohen vlerat më të shenjta të luftës së popullit të Kosovës me në krye UÇK-në, të thirremi në deklarimet e ndërkombëtarëve, siç është rasti me mikun tonë, Timoti Garton.

Me zhvillimet në Kosovë dhe roli i UÇK-së, merret edhe analisti amerikan, Pol Uiliams, ekspert për marrëdhënie ndërkombëtare, i cili në “Zërin” e datës 30 janar 1999, ishte aq largpamës sa që tërhiqte vërejtjen me vlerësimin sipas të cilit: “Është me rëndësi që sulmet ajrore të NATO-së ta gjejë UÇK-në me duar të pastra, pa vrasje të popullatës civile serbe, pa kërcënim të kufijve të jashtëm dhe në këtë mënyrë udhëheqja e UÇK-së do ta ketë dorën e fortë si moralisht, ashtu edhe strukturalisht për të hyrë në negociata”. Gjithsesi, një sugjerim dashamirës dhe shumë i vlefshëm nga një mik i madh ndërkombëtar.

Artikullshkruesi në “Zërin” e datës 6 mars 1999, duke analizuar gatishmërinë e UÇK-së që, krahas bisedimeve për Marrëveshjen e Rambujesë, të pranojë që të bëjë qeverinë bashkë me “Pacifistët”, konstaton se: “Në udhëheqësi e UÇK-së aktualisht në procesin e vendosjes për vazhdimin e luftës ose pranimin e paqes së ofruar duke përfshirë gjithë spektrin politik të Kosovës dhe se me rastin e formimit të Qeverisë, me rëndësi është që ai njeri të përfaqësojë UÇK-në, ata që me luftën e tyre kanë bërë atë që e kanë ëndërruar brezat e tërë shqiptarë”. Në të njëjtin numër të “Zërit” të datës, 16 mars 1999, duke u përgjigjur në pyetjen rreth transformimit të UÇK-së, Jakup Krasniqi, nga pozicioni i anëtarit të Shtabit të Përgjithshëm dhe zëdhënës i UÇK-së, shprehimisht thoshte se: “Unë mendoj se me transformim, në asnjë mënyrë nuk nënkupton shpërbërjen e UÇK-së, por shndërrimin e UÇK-së në forca të rregullta për mbrojtjen e Kosovës”. Analizuar nga

distanca historike, deklarimi i Krasniqit duket se ishte vizionar dhe realist, nga se, sot, 15 vjet pas çlirimit të Kosovës, UÇK-ja e transformuar në TMK dhe më pas në FSK, këtyre ditëve Qeveria e Republikës së Kosovës mori vendim për shndërrimin e FSK-së në Forcën e Armatosur të Kosovës. Ndërsa, eksperti amerikan i së drejtës ndërkombëtare, Pol Uiliams, në të njëjtin numër deklaronte se: "Çmilitarizimi i UÇK-së nuk nënkupton çarmatosjen e saj". Në përfundim të periudhës kalimtare, nuk do të bllokohen mundësitë që UÇK-ja të marrë përgjegjësi për mbrojtjen e integriteti territorial të Kosovës, dhe se UÇK-ja sipas, Pol Uiliams "...mund të shfrytëzojë periudhën kalimtare për t'u bërë një forcë sigurie në ardhmërinë e Kosovës".

Si pasojë e eskalimit të situatës së luftës në Kosovë, dhe veçmas pas fillimit të bombardimeve të NATO-së mbi caqet ushtarake, paraushtarake, policore serbe, javorja politike shqiptare "Zëri" me seli në Prishtinë, ndërpreu botimin e saj, për ta vazhduar, botimin në Shkup, deri në përfundimin e luftës së Kosovës.

